

JULJANA KUME

**MBI DISA VEÇORI MORFOLOGJIKE NË LEKSIKUN E TË
FOLMES ARVANITASE TË ISHULLIT ANDROS, GREQI**

Studimi i të folmeve të pakicave etnike shqiptare, shpërngulur gjatë periudhës së Mesjetës nga trojet etnike shqiptare, diktuar nga rrethanat historike të asaj kohe (përfshirë këtu arvanitasit e Greqisë, arbëreshët e Italisë, arbëreshët e Zarës në Kroaci dhe gjithashtu pakicat pothuajse në zhdukje të shqiptarëve të Ukrainës) kanë qenë objekt studimi i shumë historianëve dhe albanologëve vendës dhe të huaj. Ndër albanologët e shumtë të huaj, në kuadër të studimeve historike, etnografike dhe gjuhësore, kryesisht tek arvanitët e Greqisë, por edhe tek arbëreshët e Italisë, spikat shkencëtari dinjitoz dhe albanologu i kompletuar grek, prof. Titos Johalas¹.

Që në fillim të karrierës së tij si studiues është vënë re përkushtimi i tij për t'u marrë me problemet e historisë mesjetare të Shqipërisë dhe të gjuhësisë krahasuese shqipe. Dëshmi e përkushtimit dhe produktivitetit të këtij dijetari, albanologu prodhimtar, njohës shumë i mirë i disa prej të folmeve kryesore të gjuhës shqipe, janë punimet e formave dhe të përmasave të ndryshme, duke filluar që nga broshurat, separatet e deri tek vëllimet me peshë më të rëndë, të botuara në shumë gjuhë të huaja.

Një ndër veprat e shumëvëllimshme të tijat, fryt i punës së tij përkushtuese, hulumtuese dhe mbledhëse në terren është botimi me vlera të jashtëzakonshme i të folmes së ishullit Andros në Greqi *Arvanitët dhe arvanitishtja*.

Gjatë studimit të leksikut të kësaj izoglose janë spikatur disa trajta dhe tipare të veçanta fonologjike, morfologjike e si rrjedhim dhe fjalëformuese.

Gjatë këtij punimi, në mënyrë të herë pas hershme do të vihet re ndërhyrja përqaesë e disa tipareve të përbashkëta ndërmjet të folmes së marrë në studim dhe dialekteve të arbëreshëve të Italisë. I referohemi për ballafaqim të folmes së arbëreshëve të Italisë, pasi shumë elemente gjuhësore e etnografike, arvanitasit e emigruar gjatë shek. XV në Greqi i morën me vete gjatë shpërnguljes së tyre në shek. XV-XVI në Itali, kryesisht në Kalabri dhe Sicili.

Vepra e Titos Johalas, *Andros: Arvanitët dhe Arvanitishtja* është e strukturuar në katër kapituj. Pikërisht, gjatë këtij punimi do të përqendrohemi

¹ Për personalitetin shkencor të T. Johalasit dhe kontributin e tij shkencor shih më gjerë K. Frashëri, *Titos Johalas, albanologu grek që studion arvanitët*, në *Gazeta shqiptare*, 22-23 mars 2012.

tek kreu i katërt quajtur *Fjalori i arvanitishtes së Andros-it*, i cili përfshin 300 faqe (193-487).

Nga e folmja e Androsit, Johallas ka vjelë një leksik prej 1.258 njësis leksikore. Gjatë studimit të leksikut të kësaj të folme kemi evidentuar pothuajse 850 njësi leksikore, të cilat i përkasin leksikut të gjuhës shqipe, ndërsa pjesa tjetër i adresohet kontakteve të shumta historike që arvanitët kanë pasur gjatë rrjedhjes së shekujve me greqishten, italishten e turqishten.

Nëse do të shprehnim me përqindje praninë e njësisve leksikore të gjuhës shqipe në tërësinë 1.258 njësisve, 67,5% e tyre i përkasin leksikut të gjuhës shqipe, por ky raport bie ndesh me pohimin e Jochalasit se arvanitasit “nuk janë shqiptarë – ata janë arvanitë, domethënë romei (romajos), gjuha e të cilëve nuk është shqipja, por një idiomë glosologjike me një gjenezë shqiptare (alvanogjenes), e cila me kalimin e shekujve, me ndryshimet fonetike dhe me shumicën e fjalëve të greqishtes që ka përvetësuar në Greqi, është shndërruar në të folme arvanite”².

Nga sa vërtetohet dhe më sipër nuk pajtohem me mendimin e studiuesit Jochalas se “arvanitasit nuk janë shqiptarë ... dhe gjuha e tyre nuk është shqipja” . Është e vërtetë që e folmja e tyre gjatë rrjedhjes së shekujve në bashkëjetesë dhe në ndikim të vazhdueshëm me gjuhën greke ka pësuar ndryshime të ndjeshme në nivel leksikor, morfologjik, por disi edhe në atë fonetikë. Pikërisht, në këtë punim do të përqijemi të trajtojmë disa prej prej këtyre ndikimeve të greqishtes në këtë të folme. Pra, ndikimi i vazhdueshëm i gjuhës greke në këtë të folme ka sjellë disa ndryshime të dallueshme në përfaqje me të folmet e tjera si brenda kuadrit të të folmeve arvanitase ashtu sikurse ka ndikuar gjuha italiane në të folmet arbëreshe të Italisë.

Për të folmet arvanitase, ashtu sikurse për të folmet arbëreshe vlen të citojmë thënien e M. Lambertz nga bashkëjetesa në vendin e ri është përfutur një dialekt i ri, që nuk ishte i njëjtë me asnjë prej dialekteve të vendit të origjinës.

Depërtimi i disa prej greqizimeve si në të folmet arvanitase të Greqisë ashtu edhe arbëreshe të Italisë ka ndodhur para se të ndodhte zbritja e shqiptarëve në Greqi. Kështu, Jochalas në veprën e tij *Andros, arvanitët dhe arvanitishtja* ka identifikuar përafërsisht 70 njësi leksikore³ (p.sh.: *allonar-i, astrit-i, dhafn/ë-a, dhemat-i, dhjozm-i, fiteps(te), dhjozm-i, psofis(te), tirovol-i, theristi, nisi, orgomë, nafor/ë-a, lighnar, ksemolojsem* etj.) greke që kanë depërtuar në gjuhën shqipe më parë se të shpërnguleshin arvanitasit dhe arbëreshët e sotëm drejt vendndodhjeve të reja, përkatësisht në Greqi

2 K. Frashëri, Tito Johallasi, albanologu grek që studion arvanitët, në Gazeta Shqiptare, 22-23 mars 2012.

3 T. Johallas, *Andros, arvanitët dhe arvanitishtja*, Athina, 2010, f. 97. / Γιοχάλας, Τ. Ανδρός, αρβανίτες και αρβανίτικα, Αθήνα, 2010, f. 97.

(Peloponez) dhe në Italinë jugore. Nga një përjasje me leksikon e shqipes së sotme standarde, nga 70 njësitë greke rezultojnë afërsisht 24 njësi leksikore në shqipe e sotme standarde.

Kreu që pasqyron qartë dhe që të krijon bindjen e frekuencës së shpeshtë të përdorimit të greqizmeve në të folmen e Androsit është kreu i tretë i veprës *Tekste dhe këngë arvanitase të Androsit*, të cilin autori e ka vjelë nga hulumtimi në terren, drejtpërdrejt nga goja e banorëve të Androsit. Pikërisht, një ndër meritat e shumta që ka vepra e tij është dhe mbledhja e këtyre materialeve gojore, folkloristike, të vjela drejtpërdrejt nga banorët e Androsit p.sh.:

Vëmë **arghat** edhe hapëjmë themeletë. Kemi njerëz, mbanjënë gurë, kemi **htistaretë**, të tjerë mbanjënë kandunetë, gur të mëdhenj. **Htistaretë htiznjënë**. Do të marrëmë privnë edhe **arhjimjeshtrinë**. Ai **timas** baljtënë, vë edhe një gur edhe merr një gjelj edhe ve atje edhe muçi ka maljthinë, I pret krietë edhe derdh gjaghnë tekë kanduni. Prifti ka bërë **ajazmonë** edhe vë mbrenda ndë **bukali** edhe vë ndrë katrë kandune **ajazmonë**. **Meta** rrëzonjënë e htiznjënë.⁴

Njësi leksikore greke në paragrafin e mësipërm:

arghat *punëtor* < gr. εργάτης
htistaretë *ndërtuesitë* < gr. χτίστες
htiznjënë *ndërtoj* < gr. χτίζω
arhjimjeshtrinë < gr. αρχιμάστορα
timas *përgatis* < gr. ετοιμάζω
ajazmonë *ujët e bekuar* < gr. αγιασμός
meta *pastaj* < gr. μετά

Pjesa e ligjëratës që dominon në sistemin leksikor të të folmes së Androsit është emri në tri gjinitë e tij. Emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore janë më të shumtë në numër në krahasim me ata të gjinisë asnjëse.

Si emrat nga brumi i gjuhës shqipe edhe ata të huazuar nga gjuha greke dhe gjuhë të tjera në kontakt, ruajnë në rasën emërore, të njëjtën gjini prej nga vijnë dhe të njëjtin eptim të jashtme, ashtu sikurse në gjuhën standarde shqipe p.sh.: për emrat e **gjinisë mashkullore** si të fondit autokton të shqipes dhe të huazuara nga gr., apo gjuhë të tjera, i përshtaten rregullave gramatikore të shquarsisë: *diell-i*, *dimër-ri*, *gjumë-i*; *kaljë-i*, *djaljë-i*, *burrë-i*, *mí-u*, *fík-u*, *pjak-u* etj, me disa përjashtime të vogla si *ljum-i* për lumë-i. **arv.** *gjiton-i* “*komshi-u*” (gjinia mashk.) < **gr.** *re o γείτονας* (gjinia mashk.)

arv. *flevar-i* “*shkurt-i*” (gjinia mashk.) < **gr.** *re o φεβρουάριος* (gjinia mashk.)

4 T. Johalas, *Andros, arvanitët dhe arvanitishtja*, Athina, 2010, f. 130. / Γιοχαλας, T. Ανδρος, αρβανιτες και αρβανιτικα, Αθηνα, 2010, f. 130.

arv. *kaloqer-i* “verë” (gjinia mashk.) < *gr. re* *το καλοκαίρι* (gjinia asnj.)

Emrat e **gjinisë femërore**: *ditë-a*, *copë-a*, *borë-a*, *shtëpi-a*. *Huazime nga gr. në të folmen arvanitase.*

arv. *zoghrifi-a* “pikturë-a” (gjinia fem.) < *gr. re* η ζωγραφιά (gjinia fem.)

arv. *teghni-a* “art-i” (gjinia fem.) < *gr. re* η τεχνική (gjinia fem.)

arv. *ljiuri-a* (gjinia fem.) < *gr.re* η λειτουργία (gjinia fem.)

Përrjashtim bëjnë disa emra të huazuar grekë që në trajtën e pashquar përfundojnë me zanoren /-e-/ dhe që në trajtën e shquar të shqipes, temës së njësisë leksikore nuk u bashkëlidhet mbaresa /-a/ ose /-ja/ e gjuhës shqipe si p.sh.: *ljulje-ljea*, *bishtje-tjea*, *faje-qea*, *nuse-a*, *cakul-lea*, *denxere-rea*, *hjirovolve-ljea*, *kalistire-rea* etj., por për analogji të emrave të huazuara grekë, në të folmet *arv.*, dhe *arb.* ruajnë mbaresën atnike greke *-ëa*; ndërkaq kur në *gr.* e *re*, kjo trajtë e vjetër është zëvendësuar me trajtën moderne *-ia*⁵ psh.:

arv., *arb.* *erghasë-sëa* < *gr. re* η εργασία,

arv., *arb.* *folë-ljëa* < *gr. re* φολιά, η φολιά (i folia),

arv. arb. *portokàle-lea* < *gr. re* η πορτοκαλιά,

arv. arb. *thimonë-nëa* < *gr. re* η θημωνιά,

arv. arb. *vorë-rëa* < *gr. re* ο βοριάς (o vorias);

arv. *podhëa*, shq. *podhe-ja* < *gr. re* η ποδιά (i podhia);

arv. *gonëa*, shq. *gone-ja* < *ngr.* η γωνία (i gonia) etj.

Njësitë leksikore greke *-ea* (të pranishme në të folmet arvanitase dhe arbëreshe të Italisë) kanë depërtuar në këto të folme nga elementi grek i gjuhës shqipe. Kjo ka ndodhur përpara shek. të XIII, sepse më vonë dimë se popullata shqiptare nisi shtegtimin emigrues drejt Greqisë shumë kohë më parë që këto popullata të stabilizoheshin në Italinë jugore dhe në Sicili. Në fillim të shek. të XIV emrat kishin marrë mbaresën *-ia*. Në nivel morfologjik, mbaresa e vjetër ... (ea) është ruajtur në disa të folme arvanitase dhe në të folmet arbëreshe të Italisë. Pra, vëmë re se, në të folmen arvanitase të Androsit dhe në të folmet arbëreshe të Italisë shfaqet ruajtja e mbaresës së vjetër (-ea). Por, Johalas pohon se një aspekt i tillë (i ruajtjes së trajtës së vjetër greke (-ea)

5 T. Johalas, *I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh* a cura di Francesco Altamari e Leonardo M. Savoia, Presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni Editore, 1994, f. 143-144.

Mbi disa veçori morfologjike në leksikon e të folmes arvanitase të ishullit Andros

është zhdukur në greqizmat e shumë prej të folmeve të arvanitishtes dhe të gr. e re⁶.

Emrat grekë të huazuar të gjinisë asnjane janë përshtatur në të folmen e Androsit në gjininë mashkullore ose femërore p.sh.

arv. emër gj. mashkullore e femërore < gr. re emër gj. asnjane

ballë-a për ball-i në shq. < gr. re το μέτωπο (to metopo)

fustan-i < gr. re το φουστάνι (to fustani)

ljuljekuq-i < gr. re η παπαρούνα (i paparuna)

Gjinia asnjane në gjuhën shqipe është në rruhdje e sipër, por njësitë leksikore shqipe të kësaj gjinie vazhdojnë të ruhen në të folmen e arvanitase dhe arbëreshe p.sh.: *drithë-të* (drithë-i), *djathë-të* (djathë-i), *dhjamë-të* (dhjamë-i), *grurë-të* (grur-i), *gjalpë-të* (gjalpë-i), *kljumësh-të* (qumësht-i), *lesh-të* (lesh-i), *miel-të* (miell-i), *mish-të* (mish-i), *mjaltë-të* (mjalt-i), *ujë-të* (ujë-i), *valj-të* (vaj-i), *brumë-të* (brum-i) etj.

Në këtë izoglosë, elementet leksikore të shqipes të përdorura dhe të ruajtura me fanatizëm për shekuj me radhë, dhe si pasojë e ndikimit të vazhdueshëm i gjuhës dhe politikës greke kanë pësuar ndryshime të lehta fonetike dhe morfologjike, si p.sh.: ndërrimi i gjinisë i disa njësisve leksikore, si dhe ndryshime e zhvillime semantike tek njësitë leksikore si të shqipes dhe të greqishtes p.sh.:

Ndërrimi i gjinisë: *furr-i*⁷ për *furrë-a* < ο φούρνος; *ballë-a* për *ball-i* < το μέτωπο, *lemone-ea* për *limon-i* < η λεμονιά, *sorkardh-i* për *sorkadhe-ja* < το γλέκο, *ljuljekuq-i* për *lulëkuqe-ja* < η παπαρούνα; *morrë-a* për *morr-i* < η ψείρα, *brekë-a* për *brekë-t* < το σόβρακο, *këngim-a* për *kungim-i* < η μετάληψη, *bri-u* dhe jo *briri*. < το κέρατο etj.

Referuar sistemit foljor të arvanitishtes së Androsit vihen re një numër i konsiderueshëm huazimesh foljore dhe prapashtesash greke të huazuara nga gjuha greke. Si në gjuhët e tjera ballkanike dhe në të folmen arvanitase, por edhe tek arbëreshet e Italisë, foljet dhe prapashtesat greke janë të huazuara nga aoristi i foljeve greke (me prapashtesat *-os*; *-as*; *-es*; *-is*; *-aks*; *-eps*) dhe përfaqësohen nga veta e parë, njëjës, mënyra dëftore. Themi përfaqësohen nga mënyra dëftore e vetës së parë, njëjës, pasi në disa gjuhë të Ballkanit (bullg., maq.) infiniti është zhdukur, ndërsa në gjuhën shqipe ai gjen përdorim në dialektet geqe dhe është zhdukur në shqipen standarde dhe në dialektet toske.

6 T. Johalas, *I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh* a cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia, Presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni Editore, 1994, f. 143-144.

⁷ Dëgjohe dhe në të folmet e gjuhës shqipe.

Në izoglosën e Androsit, pothuajse në 90% të huazimeve foljore nga gr. u është bashkëngjitur mbaresa *-te* për formën veprorë ose *-em* për formën joveprorë të shqipes. Këto folje janë ndërtuar nga baza foljore greke p.sh.: farmak-, prapashtesë foljore e aoristit të gjuhës greke *-os-* dhe mbaresë foljore e arvanitishtes së Androsit *-te* (farmak/*os/te*) për vetën e parë njëjës, mënyra dëftore. Mbaresa e arvanitishtes së Androsit *-te* i bashkalidhet edhe njësisive foljore të shqipes p.sh.: *varte* për *var*; *thomte* për *them*; *therte* për *ther*; *trazojte* për *trazoj*; *shkojte* për *shkoj* etj. Ndërsa për të folmet arbëreshe të Italisë kjo mbaresë varion nga një e folme tek tjetra p.sh.: në të folmen arbëreshe të Shën Kostantinit prapashtesës greke i bashkëlidhet mbaresa *-enj* (farmakos*enj*). Disa shembuj njësisive foljore të formës veprorë dhe joveprorë të huazuara nga gjuha greke në të folmen e Androsit:

Forma veprorë:

arv. nakatoste < gr. *Menate zërë brumëtë, nakatosnjë edhe brunjë bukëtë. nakatosnjë* – koha e pakryer. (Në mëngjes herët zija brumin, përzieja dhe zija bukën)

arv. dhrimoniste < gr. *Grurëtë te ljami e dhrimonizhinjëm* (Grurët në lëm i shoshitëm)

arv. mboreste < gr. *Sihrish u ljeroshe, nuku mborezhnje të ruheshe një çikë po u bëshe moçi dosë.* (U bërë pisë i tëri, nuk mundeshe të kishe kujdesë pakëz, por u bërë pisë si dosë.)

arv. potiste < gr. *I potisa dhendrotë* (I vadite pemët)

arv. psofiste < gr. *Psofiste ka uja* (Ngordh nga uria)

arv. halaste < gr. *Vea ishte halasurë* (Veza na ishte prishur)

Por, në të folmen përkatëse ka njësi foljore, të cilave nuk u bashkëlidhet mbaresa karakteristike *-te* e të folmes arvanitase të Androsit p.sh.: mbores (mundem); piraks (ngacmoj); silojis (reflektoj, mendoj thellë); qerdhes (fitoj); stavros (kryqëzoi), stefanos (kurërzoi), etj.

Pra, me sa vëmë re dhe më sipër, greqizmat i përshtaten gramatikës së gjuhës shqipe dhe më konkretisht trajtave gramatikore të të folmes së Androsit. Edhe tek format joveprorë të foljeve, foljeve greke në kohën e kryer të thjeshtë u bashkëlidhen mbaresat joveprorë *-em* p.sh.: metall/*os/em*; sqe/*ps/em*; thim/*os/em*; vuv/*os/em*; ksemoloj/*is/em*, etj.

Gjatë studimit të leksikut të të folmes së Androsit janë vënë re disa zhvillime semantike të njësisive leksikore të shqipes në përfaqje me shqipen e sotme p.sh.: *shërbes-i*, ashtu sikurse në të folmen e Androsit, por edhe në dialektin arbëresh është zgjeruar semantikisht në *punë*, duke ndërruar dhe gjininë nga femërore në mashkullore për njësinë në gjuhën shq. *shërbesë-a*; *dimër-ri* ndryshon semantikisht në *shi-u*, *ecën* është zgjeruar semantikisht me

vrapoj, *këmbë* është zgjeruar semantikisht edhe në *stërkëmbësh*, *shtie* është zgjeruar semantikisht në *bie* etj p.sh.:

Shtiv shumë borë (Ra shumë borë)

Vate ndë **shërbes** (Shko në **punë**).

Gjëmon shumë, do bjerë **dimër** (Gjëmon shumë do të bjerë **shi**).

Rodha nëk **ecën** njerë (Penda e mullirit nuk **vrapon** shpejt).

I vura **këmbë**, e shtiva pordhe (I vura **stërkëmbshin** dhe e hodha përtokë).⁸

Gjithashtu, në të folmen e Androsit ruhen në gjuhën shqipe shumica e ndajfoljeve, përemrave dhe lidhëzave p.sh.: *dje*, *gjithë*, *këtej*, *këtu*, *ljark*, *ku*, *kur*, *kush* etj. Ndërsa nga gjuha greke janë të huazuara njësitë: *akoma*, *kathe* (çdo), *panda* (gjithnjë, gjithmonë), *ala* (por) p.sh.:

Panda aghapi të kemi (Gjithmonë dashuri të kemi);

Mustaqi ka veshi, **ala** dhinami çikë (Mustaqet deri tek veshi, por fuqi pak);

Ljajte **kathe** di ditë (Laj çdo dy ditë) etj.

Madhështia e punës së jashtëzakonshme të studiuesit arvanitas T. Johalasis qëndron jo vetëm tek pajisja me një leksik të thjeshtë të kësaj të folmeje, por në vjeljen e leksikut të arvanitshes të Androsit me gjithë elementet specifik të tij, shpesh me hartimin e çerdheve leksikore derivuese, me shembuj konkretë të ilustruar me fjali, shprehje frazeologjike, të mbledhura drejtpërdrejt nga goja e folësve të kësaj izoglose p.sh.:

ljum-i “lumë-i” > ljumare-ea “territori përreth lumit, brigjet dhe shtrati i lumit” me mbaresën karakteristike greke –ea etj.

Gjithashtu, në leksikon e kësaj të folmeje evidentohen ndërtimet e njësisive leksikore të përbëra, ku me interes janë formimet e përbëra leksikore, ku pjesa bazë e njësisë leksikore është në gjuhën shqipe dhe pjesa e dytë, përbërse, cilësore e saj në gjuhën greke p.sh.:

arv. *aghrio/gjel-i* < gr. *άγριος* + shq. *gjel-i* = pupëzë-a (përkthimi fjalë për fjalë: *gjel i egër*)

arv. *ajo/mëma* < gr. *άγριος* + shq. *mëma* = mëma e shtrenjtë

arv. *arhi/mjeshtri* < gr. *αρχι* + shq. *mjeshtri* = kryemjeshtri

arv. *para/nuse-sea* < gr. *para* + shq. *nuse* = nuse-ja

arv. *ksilo/ghajdharë-a* < gr. *η ξυλογαϊδάρα* = gomar për të mbajtur dru.

⁸ T. Johalas, *Andros, arvanitët dhe arvanitshja*, Athina, 2010. / Γιοχλας, T. Ανδρος, αρβανίτες και αρβαντικά, Αθήνα, 2010.

Gjatë huazimeve leksikore kanë depërtuar në gjuhën shqipe, por edhe në të folmen e Androsit, prapashtesat greke, të cilat i janë veshur njësive leksikore përkatëse p.sh.:

prapashtesa –it: arv. psorjanit-i (banor i Psoriaresës).

Brenda shq. me këtë prapashtesë gr. janë formuar etnika p.sh.: Gjirokastrit, Zagorit, Mashkullorit etj.

prapashtesa –omë: dhom/ë-a, dhrom-i, fllom-i, orgom/ë-a etj.

Kjo prapashtesë rrjedh nga prapashtesa e gr. dhe njësive greke që kanë depërtuar në këtë të folme, por edhe në gjuhën shqipe. Kjo prapashtesë është bërë produktive edhe me fjalë të shqipes p.sh.: buromë, kredhomë, zezomë etj.

Së fundmi, nga studimi i leksikut përkatës sipas fushave semantike, vihet re se, fondi themelor i gjuhës shqipe ruhet kryesisht në fushat terminologjike të botës së kafshëve dhe të shpendëve, të bimësisë, të ushqimit, të natyrës, në emërtime të pjesëve të trupit të njeriut, etj, p.sh.:

Emërtimet e kafshëve: *Dòsa ishtë bàrsë e pòlli dirqitë (derrat). Kali u psofis (Kali ngrodhi).*

Emërtimet e bimësisë dhe ushqimit: *Fiku u tha. Dàrdha pràpa e ka bishtinë. Vemi të mbljèthmë ljàkra të ègra. Të marrsh një hùdhërë për si.*

U doq ljakruari.

Emërtimet e natyrës: *Ndighetë shumë dèti, pse frin shumë (Dëgjohet shumë deti, sepse fyrr shumë era). Gjëmòn shumë, do bjërë dimër (Gjëmon shumë, do të bjerë shi). Ra një il (Ra një yll).*

Emërtimet e pjesëve të trupit të njeriut: *Mblille grikënë. Fshighe grikënë. Hùnda më rrjedh gjak.*

Fushat e tjera semantike në të folmen e Androsit plotësohen nga një pjesë e mirë e greqizmeve të kësaj të folmeje, të cilat i përkasin kryesisht, fushave të vendbanimit, të orendive shtëpiake, të mjeteve artizanale, agrikultivuese e bujqësore, profesioneve e zanateve, gjendjes fizike, psikologjike dhe emocionale; fesë, supersticiozitetit dhe folklorit, por gjithashtu, greqizmat në këtë të folme luajnë rol plotësues në fushat semantike si të kafshëve, bimëve dhe pemëve ku kryesisht zotërohen nga terminologjia e gjuhës shqipe etj, p.sh.:

Feja, supersticioziteti dhe folklori: *Prifti ka bërë ajazmònë (ujët e bekuar). Neve ka të diemë çë aj na sòli evlojinë? (Ku ta dimë ne, se ajo gjë na sollli bekimin).*

Profesione dhe zanate: *Do vëmë dhraghàt (roje), të rùajnë àratë. Ipurghòtë (ndihmësi i mjeshtrit në ndërtim) izhnë atà çë bënjënë bàljtë edhë e mirrnë bàljtënë edhë gùrètë edhë i qàzhnjënë àfrë te mjështri.*

Familja dhe farefisi, të afërmit: *Të rrònjë nùsea edhë ghambroi (dhëndërr). Kàmte gjitònë të qèrdhmë dhëntë (Kam komshinj që qethin dhentë).*

Sa më lart parashtruar, duam të shtojmë se, ky është fillimi i një pune të gjatë studimore jo vetëm në lidhje me greqizmat e pranishme në këtë të folme, të cilat janë të shumta; por njëkohësisht i një studimi të hollësishëm i fjalëformimeve, i trajtave fonetike, morfologjike dhe zhvillimeve semantike të njësive leksikore të shqipes me përdorim në të folmen e Androsit, si dhe të gjitha të folmet e tjera arvanitase.

Përfundime:

- Johalas në veprën *Andros, Arvanitët dhe arvanitishtja* ka hartuar një fjalor prej 1.258 njësish leksikore, prej nga 850 njësi leksikore (shprehur në përqindje 67,5%) i përkasin leksikut të gjuhës shqipe. Pjesa tjetër e njësive leksikore i adresohet kontakteve të shumta historike që arvanitët kanë pasur gjatë rrjedhjes së shekujve me greqishten, italishten e turqishten. Një numër afërsisht prej 70 njësish greke kryesisht të periudhës së re kanë depërtuar në të folmet përkatëse (arvanitase) përpara zbarkimit të hershëm të shqiptarëve në atdheun e ri, përkatësisht në të folmet arvanitase, por, normalisht edhe arbëreshe.

- Meritë tjetër e veprës së tij është edhe vjelja në terren e materialeve gojore, folkloristike, drejtpërdrejt nga banorët e Androsit.

- Pjesa e ligjëratës që dominon në sistemin leksikor (përfshirë njësitë leksikore të gjuhës shqipe, por dhe ato të gjuhës greke) të të folmes së Androsit është emri në tri gjinitë e tij. Emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore janë më të shumtë në numër në krahasim me ata të gjinisë asnjëse.

- Disa prej njësive leksikore greke të gjinisë femërore, në disa të folme arvanitase, por edhe në të folmet arbëreshe të Italisë vazhdojnë të ruajnë mbaresën atnike greke *-ëa*; ndërkaq kur në gr. e re, kjo trajtë e vjetër është zëvendësuar me trajtën moderne *-ia*⁹ psh.: *arv., arb. erghasè-sèa* < *gr. re η εργασία* etj.

- Në izoglosën e Androsit, pothuajse 90% e huazimeve foljore nga gr. u është bashkëngjitur mbaresa *-te* për formën veprorë ose *-em* për formën joveprorë të shqipes. Këto folje janë ndërtuar nga baza foljore greke p.sh.: **farmak-**, prapashtesë foljore e aoristit të gjuhës greke *-os-* dhe mbaresë foljore e arvanitishtes së Androsit *-te* (farmak/*os/te*). Pra, greqizmat i përshtaten gramatikës së gjuhës shqipe dhe më konkretisht trajtave gramatikore të të folmes së Androsit.

- Zhvillime semantike interesante të njësive leksikore të shqipes së Androsit në përqsje me shqipen e sotme vihen re në disa prej njësive leksikore të shqipes p.sh.: *shërbes-i* zgjeruar semantikisht në *punë*, duke

9 T. Johalas, *I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh* a cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia, Presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni Editore, 1994, f. 143-144.

ndërruar dhe gjininë për njësinë në gjuhën shq. *shërbesë-a; dimër-ri* ndyshon kuptimisht në *shi-u, ecën në vrapoj, këmbë* zgjeruar semantikisht edhe në *stërkëmbësh, shtie* zgjeruar semantikisht në *bie* etj.

BIBLIOGRAFI

Fjalori i gjuhës shqip 1980

Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.

K. Frashëri, Tito Johalasi, albanologu grek që studion arvanitët, në *Gazeta Shqiptare*, 22-23 mars 2012.

Pasquale Scutari, *Dizionario arbëresh di San Costantino Albanese*, Presentazione di Francesco Altimari, Università della Calabria, Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia (2010).

T. Johalas, *Andros, arvanitët dhe arvanitishtja*, Athina, 2010. / Γιοχάλας, Τ. Άνδρος, αρβανίτες και αρβανίτικα, Αθήνα, 2010.

T. Johalas, *I dialetti italo-albanesi, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Considerazioni sull'elemento greco nell'arbëresh* a cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia, Presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni Editore, 1994.